



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:080374

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03380380

P.nr.145/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. F. nga fsh. . . .K Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nen par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë PP nr. 261/22 të datës .14.04.2022,në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **22.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Anton Hasanaj si dhe të akuzuarit , me datën 23.08.2022 morri dhe publikisht n shpalli , ndërsa përpilojë me dt. 29.08.2022 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R. F.** nga fsh. . . .K Gjakovë ,data e lindjes . . . , i biri i F. dhe i nënës C. e gjinisë A. , ka te kryer shkollën fillore , punëtor fizike , i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar atë i 4 fëmijëve , shqiptar ,shtetas R. Kosovës , me ID . . .

Ë s h t ë f a j t o r :

Sepse:

-me datë 26.07.2019 rreth orës 16:00 në fshatin . . .K-Gjakovë, saktësisht afër Stacionit të Policisë, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit/viktimës së ndjeshme S. Q., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin mes vete ku i pandehuri dyshonte se i dëmtuari i'a kishte ngacmuar gruan dhe i njëjti e kishte denoncuar rastin në polici, ashtu që ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke dalë nga stacioni i policisë takohet me të pandehurin R., i cili i afrohet të dëmtuarit ku fillimisht i drejtohet me fjalët *“ti ma ke ngacmuar gruan”* dhe menjëherë e godet me grusht në fytyrë, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr. V. K.me numër të referencës 06/2022 datë 19.02.2022.

-me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në mbështetje të nenit 4,17, 38,46,47,48,49,69,70 , nenit 185 par.3 nen par. 3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **7 (shtatë) muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1(një) viti** , nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

I dëmtuari S. Q. nga fshati . . . Komuna Gjakovë ,për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumen prej 20.00. € (në emër të ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30.00 €, në afat prej 15 ditëve ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP/II nr. 261/22 te dt. 14.04.2022, kundër të akuzuarit R. F. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nen par. 3. 1 lidhur me par . 1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datën 22.08.2022,Prokurori i shteti Anton Hasanaj lexoi aktakuzën PP nr. 261/22 dt.14.04.2022,me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës

I akuzuari R. F. , në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë, thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt me qenë se siç kam deklaruar edhe në st. policor i njëjti më ka provokuar në sy të bashkëshortes dhe vajzës në parkingun e st. policor ku unë pasi kam vërejtur se i njëjti është drejtuar nga unë e kam shtyrë ,me ç ‘rast i njëjti është rrezuar dhe ka pësuar lëndimet e cekura , premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe do të jem më i kujdesshëm duke i kërkuar falje nga i dëmtuari për veprimet e mia, andaj bazuar në të gjitha këto i propozoi gjykatës që të merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë , pendimin e shprehur në gjykatë dhe premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet ,faktin se më parë nuk kam ra ndesh me ligjin të më shqiptojë një dënim më të butë me që është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin ,gjendjen e dobët ekonomike me qenë se jam mbajtësi i vetëm i familjes prej 6 anëtarëve me të ardhura që i realizojë si punëtor fizik të më shqiptojë një dënim më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari , Prokurori i shtetit Anton Hasanaj , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit R. F., gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor , pasi që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare duke i kuptuar më parë pasojat dhe benefitet e pranimi të fajësisë , po ashtu pranimi i fajësisë ka mbështetje të plotë që e mbështetin aktakuzën, andaj vlerësojë se pranimi i fajësisë është bërë në pajtim me nenin 248 , për çka gjykatës i propozoi që të aprovojë pranimin e fajësisë si shprehje e lirë e vullnetit dhe të akuzuarit të ja shqiptojë një dënim meritator konform ligjit dhe atë duke marr parasysh të gjitha rrethanat renduese dhe lehtësuese të parapara me dispozitat e KPRK-ës. Po ashtu i akuzuari të obligohet në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. F. :-me datë 26.07.2019 rreth orës 16:00 në fshatin . . .K-Gjakovë, saktësisht afër Stacionit të Policisë, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit/viktimës së ndjeshme S. Q., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishin mes vete ku i pandehuri dyshonte se i dëmtuari i’ a kishte ngacmuar gruan dhe i njëjti e kishte denoncuar rastin në polici, ashtu që ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke dalë nga stacioni i policisë takohet me të pandehurin R., i cili i afrohet të dëmtuarit ku fillimisht i drejtohet me fjalët “*ti ma ke ngacmuar gruan*” dhe menjëherë e godet me grusht në fytyrë, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore me pasojat të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko ligjor të Dr. V. K.me numër të referencës 06/2022 datë 19.02.2022.-me çka ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cilit në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Për të akuzuarin rrethanë rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se i njëjti është baba i 4 fëmijëve, sjelljen e tij para kryerjes së veprës penale ka qenë korrekte. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetit i tij që te gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt, i urtë dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, është penduar thellë për veprën penale .Ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjykata vlerësoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari ,shprehjen e keq ardhjes për rastin që i ka ndodhur në afekt, kërkim falje nga i dëmtuari për veprimet e tij o, të cilat rrethana ndikuan qe gjykata ti zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit te parapara ne nenin 70 te KPRK-ës, gjykata te akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim ne kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit prej 1(një) viti ,nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ,do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij ,do të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale , ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin S. Q. për realizimin e kërkesës pasurore juridike ai udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në shumë prej 20 .00 € (në emër të ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe në emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30.00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.145/22 më datë 23.08.2022**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 , ditësh**, nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë .Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.